

ECURIA E REKOMANDIMEVE TË KI JANAR - QERSHOR 2024

MBLEDHJE E KËSHILLIT TË INVESTIMEVE
Tiranë, 3 shtator 2024

ECURIA E REKOMANDIMEVE TË KI, JANAR - QERSHOR 2024

334
rekomandime në
total

48,2% e
rekomandimeve
të zbatuara*

113
rekomandime të
paplotësuara
Peshën më të
madhe në e zënë
rekomandimet e
dhëna në
mbledhjet mbi
“Potencialet e
Investimeve”
“Siguria Juridike
mbi Pronën”.

Sekretariati i KI
përditëson
statusin e
rekomandimeve
bazuar në
përgjigjet formale
nga insitucionet
zbatuese dhe
burime dytësore
informacioni.

Evidentuar
gatishmëri e
institucioneve
publike mbi
dhënien e
informacionit në
lidhje me
përbushjen e
rekomandimeve
të KI, por
përgjigjet e
dhëna janë të
përgjithshme.

Progres pozitiv në
17 rekomandime.
Tre sektorët më
të ndikuar:
Turizmi, Bujqësia
dhe
Agropërpunimi.

*Plotësisht (80-100%) ose pjesërisht (50-70%)

ECURIA E REKOMANDIMEVE TË KI, JANAR - QERSHOR 2024

Nga rekomandimet që ndikojnë të gjithë sektorët:

Digjitalizimi i shërbimeve publike administrative vendore për biznesin, AKSHI në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, janë në proces negociatash me Bankën Botërore për mundësi financimi shtesë me qëllim zgjerimin e operacionit të përbashkët ekzistues duke përfshirë dhe ri-inxhinierimin administrativ, transformimin digjital dhe modernizimin e financave vendore si dhe integrimin e qeverisjes vendore në infrastrukturën digjitale të qeverisë qendrore.

Mundësimi i sistemit të pagesave online për shërbimet administrative qendrore. Nga bashkëpunimi mes AKSHI, BSH, Shoqata e Bankave dhe Bankat e nivelit të dytë në Shqipëri, është arritur dhe me ndërmjetësimin e Ministrisë së Financave nënshkrimi i një memorandum bashkëpunimi për Projektin e digjitalizimit për pagesat elektronike për shërbimet publike. Bankat e nivelit të dytë po kryejnë zhvillime teknike për të ofruar mundësinë e kryerjes së pagesave online për 17 shërbime online.

Ndikim i besimit në platformat online përmes mbrojtjes së sigurisë së informacionit të shkëmbyer në platformat digjitale ku ofrohen shërbime administrative. AKSHI ka hartuar dhe miratuar dokumentin “Udhëzim për Zbatimin e Dokumentit të Përditësuar të Vazhdimësisë dhe Planit për Ruajtjen e Informacionit . Ky dokument përmban veprimet dhe masat që duhet të merren për të mbështetur dhe garantuar vazhdueshmërinë e punës.

Lehtësim i procesit të ndërmjetësimit të punësimit nga AKPA përmes platformës së centralizuar puna.gov.al . Në platformën e ngritur nga AKPA është synuar rritje e ndërveprimit mes punëdhënësve dhe punëkërkesve, ku këta të fundit mund të aplikojnë direkt te vendi i lirë pa pjesëmarrjen e Zyrës së Punës. Janë mbajtur takime rajonale midis institucioneve në varësi të AKPA si Zyrat e Punës, QFP dhe Shkollat e Arsimit Profesional si dhe takime informative me palët e interesuara duke nxitur pjesëmarrjen në shërbimet dhe programet që AKPA ofron.

ECURIA E REKOMANDIMEVE TË KI, JANAR - QERSHOR 2024

Nga rekomandimet në sektorin e Turizmit:

Përpjekje për standartizim të cilësisë së shërbimit përmes saktësimit të kategorive dhe klasifikimit të subjekteve turistike. Përveçse shtuar kategoritë e strukturave dhe detajuar klasifikimi i tyre, është bërë e detyrueshme që edhe individët që lëshojnë dhoma, vila e apartamente të marrin një certifikatë kategorizimi dhe certifikatë klasifikimi në Ministri para se të fillojnë aktivitetin akomodues (edhe pse jo domosdoshmërisht duhet të regjistrohen në QKB).

Strukturim i mbledhjes, përpunimit dhe prodhimit të statistikave për turizmin bazuar në të dhëna të konsoliduara. Kjo ndikon në hartimin e politikave dhe strategjive të bazuara në analiza reale të dhënash si dhe jep një pasqyrë më të saktë mbi informalitetin në turizëm. Ndryshimet konkrete të miratuara në ligj lidhen me dy nene përmes të cilëve përcaktohet mënyra e detyruar e mbledhjes së të dhënave në formë raportimi nga institucionet publike qendrore e vendore, nga strukturat akomoduese, operatorët turistikë dhe agjencitë e udhëtimit. Gjithashtu krijohet edhe “Komiteti për të dhënat statistikore në turizëm” si një organ koordinues pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin, kryesuar nga Ministri.

ECURIA E REKOMANDIMEVE TË KI, JANAR - QERSHOR 2024

Nga rekomandimet në sektorin e Bujqësisë:

Përditësimi dhe transparenca në kohë në lidhje me hartat dixhitale të tipeve të tokës bujqësore që orientojnë fermerët. Finalizuar:

- 1) Inventarizimi dhe klasifikimi i tokave bujqësore sipas përshtatshmërisë së saj;
- 2) Studimi agro-ekologjik i zonave në studim;
- 3) Dixhitalizimi i regjistrit të tokës bujqësore për bashkitë Berat, Delvinë, Finiq, Kolonjë, Kuçovë, Lushnje, Roskoves dhe pjesërisht Vlorë . Për Fierin e Korçën të dhënat do të jenë në Sistem online brenda Dhjetorit 2024.
- 4) Krijimi i programit WEB-GIS

Përpjekje për nxitjen e bashkëpunimit dhe kooperimit midis fermerëve përmes bashkimit në grupe fermerësh apo SHBB. Në Skemën Kombëtare të Mbështetjes për vitin 2024, ishin 321 aplikime nga grupe fermerësh (me 1685 fermerë në total) dhe 21 aplikime nga Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor që favorizohen me masë përfitimi të plotë në nivelin 100% në krahasim me fermerët individual. Gjithashtu u rikthye mbështetja për bimët mjekësore dhe aromatike (BMA) të kultivuara.

Nxitje e formalizimit në sektor përmes finalizimit të regjistrimit të Fermave/Fermerëve dhe paisjes me Kartat e Fermerit. Janë saktësuar dhe përditësuar të dhëna për rreth 133 mijë ferma aktive të autorizuara nga Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor. Të gjithë aplikantët, përpara përfitimit të tyre nga masat mbështetëse të Skemës Kombëtare e kanë të detyrueshme të plotësojnë/përditësojnë Regjistrin e Fermës. Regjistri është integruar në sistemin e AZHBR për aplikimin online të pagesave direkte.

Fokusim dhe përmirësimi i metodologjisë për grumbullimin, përpunimin, shkëmbimin dhe analizimin e të dhënave për Bujqësinë dhe Agropërpunimin në bashkëpunim me institucione të tjera raportuese për analiza më të mira sektoriale dhe orientim të politikave. Në MBZHR është krijuar Drejtoria e Statistikave, Analizës dhe Raportimeve, e përbërë nga 2 sektorë, është inicuar bashkëpunimi me donatorë dhe INSTAT për përmirësimin e metodologjisë për grumbullimin, përpunimin, shkëmbimin dhe analizimin e të dhënave.

ECURIA E REKOMANDIMEVE TË KI, JANAR - QERSHOR 2024

Nga rekomandimet në sektorin e Agropërpunimit:

Nxitje e bashkëpunimit rajonal, sinergji për potenciale të reja për rajonin me qarkullim të lirë të mallrave, punëdhënësve dhe kapitaleve, dhe lehtësim i barrierave jo-tarifore.

(1) Certifikata fitosanitare shqiptare njihet dhe pranohet nga të gjitha vendet e botës pasi është konform me modelin e çertifikatës fitosanitare të IPPC (International Plant Protection Convention). Autoriteti fitosanitar shqiptar ka negociuar dhe dakortësuar me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor për njohjen dhe pranimin reciprok të certifikatave fitosanitare që shoqërojnë eksportet e produkteve bujqësore.

(2) ISUV është mbështetur financiarisht për rritjen e kapaciteteve laboratorike dhe teknike për akreditimin e metodave të analizës së produkteve bujqësore. Analizat e kryera në ISUV janë akredituar bazuar në normat e përcaktuara sipas acquis së BE-së. Certifikata e Akreditimit e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për analizat e akredituara, njihet nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së.

FALEMINDERIT!

www.investment.com.al

Këshilli Investimeve mbështet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO).